



Drasmat / Dorezat Primitje / Prizdate Receipt / Delivery	20.09.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org. Unit	Ri / Prot Ri / Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHEK	2268/2022		1/7



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.747/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës -Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: Arben Mehmeti - Kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca, anëtarë, me Clirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2767/2021 i datës 15.03.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.747/2021 e datës 20.08.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Vërejte", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.747/2021 e datës 20.08.2021 e parashtruar nga ankuesja
- II. Anulohet masa disiplinore "Vërejtja" me Shkrim e datës 29.07.2021, e shqiptuar përmes formës elektronike nga Drejtori i Drejtoratit për Pajisje me Dokumente.
- III. OBLIGOHET Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke nxjerrë vendim për fshirjen e Vërejtjes të datës 29.07.2021 të shqiptuar nga Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë dhe largimin e saj nga dosja e ankuesit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesja [REDACTED] me datë 20.08.2021, me numër protokolli 4296/2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, të Kosovës me pretendimet ankimore se Drejtori i Drejtoratit për Pajisje me Dokumente, i ka shqiptuar "vërejtje" përmes formës elektronike më datë 29.07.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datë 30.08.2021, me numër protokolli 4446/2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme ndërsa me datë 10.09.2021, me numër protokolli 4567/2021, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme, me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me qenë se nuk ka qenë funksional në këtë periudhë për vendosje, me shkresën me numër protokolli 4852/2021 të datës 30.09.2021 ka udhëzuar ankuesen për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, më datë 15.03.2022 ka nxjerr Aktgjykimin Anr.2767/2021 përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtojë dhe të vendos për ankesën A.nr.747/2021 e datës 20.08.2021 të parashtruar nga ankuesja

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 4296/2021 të datës 20.08.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2767/2021 i datës 15.03.2022; fletë kthesë e datës 05.10.2021; Njoftim me numër protokolli 4852/2021 i datës 30.09.2021; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 30.08.2021; Fletë kthesë e datës 02.09.2021; Vërejtje me shkrim e datës 29.07.2021 e shqiptuar përmes e-mailit nga Drejtori i Drejtoratit për Pajisje me Dokumente; E-mail nga M.Th. për A.H i datës 27.07.2021; E-mail nga M.Th. për A.H i datës 19.07.2021; E-mail nga A.H. për A.M. i datës 13.07.2021; E-mail nga A.H. për T.B. i datës 29.07.2021; E-mail nga M.Th për A.H. i datës 19.07.2021; E-mail nga A.H. për T.B. i datës 19.07.2021; E-mail nga T.B. për A.H. i datës 19.07.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 27.05.2021; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 14.05.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 14.05.2021; E-mail nga M.H. për R.B. i datës 12.05.2021; E-mail nga L.E. për M.H. i datës 12.05.2021; E-mail nga M.B. për N.Sh. i datës 12.05.2021; E-mail nga A.H. për Sh.M. i datës 26.05.2021; E-mail nga A.H. për Sh.M. i datës 21.05.2021; E-mail nga Sh.M. për A.M. i datës 19.05.2021; E-mail nga A.K. për S.B. i datës 18.05.2021; E-mail nga S.B. për A.K. i datës 18.05.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 14.04.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 31.03.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 16.03.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 12.03.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 03.03.2021; E-mail nga A.H. për M.Th. 03.03.2021; E-mail nga M.Th. për Sh.M. i datës 03.03.2021; E-mail nga A.H. për Sh.M. i datës 03.03.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 03.03.2021; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 03.03.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 08.02.2021; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 19.07.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 19.07.2021; E-mail nga A.H. për T.B. i datës 19.07.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 16.07.2021; E-mail nga L.S. për F.Sh. i datës 16.07.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 17.06.2021; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 17.06.2021; E-mail nga R.G. për A.H. i datës 17.06.2021; E-mail nga A.H. për "L.E." i datës 04.03.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 03.03.2021; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 03.03.2021; E-mail nga M.Th. për Sh.M. i datës

03.03.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 03.03.2021; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 03.03.2021; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 07.10.2020; E-mail nga M.Th. për T.B. i datës 07.10.2020; E-mail nga S.B. i datës 05.10.2020; E-mail nga A.H. për B.H. i datës 11.03.2020; E-mail nga B.S. për A.H. i datës 11.03.2020; E-mail nga E.A. për S.B. i datës 11.03.2020; E-mail nga M.K. për B.C. i datës 11.03.2020; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 03.03.2020; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 02.03.2020; E-mail nga T.B. për A.H. i datës 26.02.2020; E-mail nga T.B. për A.H. i datës 26.02.2020; E-mail nga A.H. për T.B. i datës 26.02.2020; E-mail nga A.H. për A.M. i datës 30.01.2020; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 14.09.2020; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 15.07.2020; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 27.05.2020; E-mail nga M.Th. për V.S. i datës 12.03.2020; E-mail nga R.L. për B.H. i datës 04.03.2020; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 05.12.2019; E-mail nga B.B. për A.H. i datës 05.12.2019; E-mail nga A.H. për H.K. i datës 05.12.2019; E-mail nga A.H. për T.B. i datës 29.07.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 19.07.2021; E-mail nga A.H. për T.B. i datës 19.07.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 19.07.2021; E-mail nga A.H. për T.B. i datës 19.07.2021; E-mail nga M.D. për A.H. i datës 28.07.2021; E-mail nga A.H. për H.M. i datës 28.07.2021; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 28.05.2021; E-mail nga A.H. për Sh.M. i datës 26.05.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 27.05.2021; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 14.05.2021; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 06.02.2020; E-mail nga M.Th. për Z.R. i datës 05.02.2020; E-mail nga Z.R. i datës 03.02.2020; Ankesë me numër protokolli 44/20 e datës 24.01.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i A.H. i datës 30.12.2019; Aktpajtim me numër 05/2020 i datës 18.02.2020; E-mail nga RimsMPB për A.H. i datës 22.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i A.H. i datës 30.12.2020; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 22.01.2021; E-mail nga RimsMPB për A.H. i datës 21.01.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 22.01.2021; E-mail nga RimsMPB për M.Th. i datës 22.01.2021; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 22.01.2021; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 19.01.2021; E-mail nga RimsMPB për A.H. i datës 18.01.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 06.01.2021; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 05.01.2021; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 05.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i A.H. i datës 30.12.2020; E-mail nga A.H. për L.E. i datës 11.01.2021; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 05.01.2021; E-mail nga RimsMPB për A.H. i datës 30.12.2020; E-mail nga S.B. për A.H. i datës 22.09.2020; E-mail nga A.H. për S.B. i datës 22.09.2020; E-mail nga A.H. për S.B. i datës 21.07.2020; E-mail nga S.B. për B.S. i datës 16.07.2020; E-mail nga A.H. për S.B. i datës 16.07.2020; E-mail nga T.B. për A.H. i datës 16.07.2020; E-mail nga B.S. për S.B. i datës 17.07.2020; E-mail nga S.B. për B.S. i datës 16.07.2020; Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile me numër E24438357; E-mail nga B.H. për A.H. i datës 23.12.2020; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 21.12.2020; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 09.10.2020; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 09.10.2020; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 07.10.2020; E-mail nga M.Th. për T.B. i datës 07.10.2020; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 25.09.2020; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 24.09.2020; E-mail nga A.H. për S.B. i datës 22.09.2020; E-mail nga A.H. për S.B. i datës 21.07.2020; E-mail nga S.B. për A.H. i datës 17.07.2020; E-mail nga A.H. për S.B. i datës 16.07.2020; E-mail nga T.B. për A.H. i datës 16.07.2020; E-mail nga A.H. për T.B. i datës 15.07.2020; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 24.09.2020; E-mail nga M.Th. për B.H. i datës 24.09.2020; E-mail nga B.H. për M.Th. i datës 24.09.2020; E-mail nga A.H. për T.B. i datës 29.07.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 19.07.2021; E-mail nga A.H. për T.B. i datës 19.07.2021; E-mail nga T.B. për A.H. i datës 19.07.2021; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 19.07.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 19.07.2021; E-mail nga A.H. për T.B. i datës 19.07.2021; E-mail nga M.D. për A.H. i datës 28.07.2021; E-mail nga A.H. për H.M. i datës 28.07.2021; E-mail nga A.H. për A.M. i datës 13.07.2021; E-mail nga B.C. për Sh.M. i datës 15.06.2021; E-mail nga Sh.M. për B.C. i datës 15.06.2021; E-mail nga Sh.M. për B.C. i datës

10.06.2021; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 24.05.2021; E-mail nga S.B. për A.H. i datës 25.02.2020; E-mail nga A.H. për S.B. i datës 24.02.2020; E-mail nga A.H. për S.B. i datës 10.02.2020; E-mail nga A.H. për Sh.M. i datës 16.12.2019; E-mail nga A.H. për S.B. i datës 10.12.2019; E-mail nga A.H. për A.M. i datës 05.12.2019; E-mail nga S.B. për M.Th. i datës 22.11.2019; Përgjigje në ankesë e datës 10.09.2021; Ndryshimi i Aktit të Emërimit i A.H. i datës 14.12.2018; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 27.02.2014; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i A.H. i datës 08.06.2020; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 19.07.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 19.07.2021; E-mail nga A.H. për T.B. i datës 19.07.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 16.07.2021; E-mail nga L.S. për F.Sh. i datës 16.07.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 17.06.2021; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 17.06.2021; E-mail nga R.G. për A.H. i datës 17.06.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 27.05.2021; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 14.05.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 14.05.2021; E-mail nga M.H. për R.B. i datës 12.05.2021; E-mail nga L.E. për M.H. i datës 12.05.2021; E-mail nga M.B. për N.Sh. i datës 12.05.2021; E-mail nga A.H. për Sh.M. i datës 26.05.2021; E-mail nga A.H. për Sh.M. i datës 21.05.2021; E-mail nga Sh.M. për A.M. i datës 19.05.2021; E-mail nga A.K. për S.B. i datës 18.05.2021; E-mail nga S.B. për A.K. i datës 18.05.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 14.04.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 31.03.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 16.03.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 12.03.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 03.03.2021; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 03.03.2021; E-mail nga M.Th. për Sh.M. i datës 03.03.2021; E-mail nga A.H. për Sh.M. i datës 03.03.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 03.03.2021; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 03.03.2021; E-mail nga M.Th. për A.H. i datës 08.02.2021; E-mail nga A.H. për L.E. i datës 11.01.2021; E-mail nga A.H. për M.Th. i datës 05.01.2021; E-mail nga RimsMPB për A.H. i datës 30.12.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i A.H. i datës 30.12.2020; E-mail nga RimsMPB për A.H. i datës 30.12.2020; E-mail nga RimsMPB për A.H. i datës 18.01.2021; E-mail nga RimsMPB për A.H. i datës 21.01.2021; E-mail nga RimsMPB për A.H. i datës 22.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i A.H. i datës 30.12.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i A.H. i datës 08.06.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i A.H. i datës 30.12.2019; E-mail nga T.T për C.Z. i datës 13.04.2022; E-mail nga C.Z. për T.T. i datës 13.04.2022; Të dhënat nga libri amzë për M.P. nr.183;

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e bazuar ,SEPSE:*

Kolegji ka shqyrtuar pretendimet e ankueses \_\_\_\_\_ e cila deklaroi se Drejtori i Drejtoratit për Pajisje me Dokumente,i ka shqiptuar vërejtjen më datë 29.07.2021, përmes formës elektronike, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi duke konstatue gabimisht gjendjen faktike, poashtu vërejtja është mbi bazë të tendencave të caktuara, ndërsa ankuesja ka sqaruar secilin pikë që ka qenë objekt i vërejtjes së dhënë ankueses.

Poashtu kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Drejtori i Drejtoratit për Pajisje me Dokumente masën disiplinore "vërejtje" i ka shqiptuar me arsyetimin për shkak të, papërgjegjësisë, mospërmbushjes së detyrave të punës si dhe sjellje e parregullt, gjatë kohës së punës me mbikëqyrësit, kolegët ,vartësit dhe publikun sipas nenit 46 të ligjit nr. 06/-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores nr.11/2020,duke mos përmbushja e detyrave të punës sjellja e

parregullt gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, duke sqaruar pikat kryesore të vërejtjes që janë objekt i kësaj ankese.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar pretendimet kryesore të ankueses sa i përket "vërejtjes", të shqiptuar nga Drejtori i Drejtoratit për Pajisje me Dokumente dhe duke u bazuar në provat e administruara në lidhje me këtë lëndë, ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara mbi bazë të arsyeve të specifikuara më poshtë.

Bazuar në provat e lëndës, respektivisht në përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Letërnjoftimeve" të datës 27.02.2014 janë përcaktuar detyrat kryesore të punës si: **Detyra 1.** Koordinon punën për pajisje me letërnjoftime:20%. **Detyra 2.** Kujdeset për zbatimin e legjislacionit dhe procedurave në fushën e aplikimit dhe pajisjes me letërnjoftime:10%. **Detyra 3.** Bashkëpunon dhe u jep këshilla profesionale Udhëheqësve të QPD-ve dhe stafit për pajisje me letërnjoftime:10%. **Detyra 4.** Mban evidenca lidhur me aplikacionet dhe lëshimin e letërnjoftimeve:15%. **Detyra 5.** Përgatit raporte të rregullta lidhur me lëshimin e letërnjoftimeve:10%. **Detyra 6.** Bashkëpunon me Drejtoratin për Prodhimin e Dokumenteve lidhur me prodhimin e letërnjoftimeve:15%. **Detyra 7.** Udhëheqësi i Sektorit të Letërnjoftimeve raporton tek Udhëheqësi i Drejtoratit për Pajisje me Dokumente:10%. **Detyra 8.** Është përgjegjës për vlerësimin periodik dhe vjetor të punës së zyrtarëve të Sektorit për Letërnjoftime:5%. **Detyra 9.** Kryen edhe punë të tjera që kërkohen nga Udhëheqësi i Drejtoratit për Pajisje me Dokumente:5%.

Lidhur me këtë çështje juridike, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se fillimisht mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunëses civile, në rastin e shqiptimit të masës disiplinore duhet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil, siç parashihet me nenin 48 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë në të cilën dispozitë specifike parashihet: "Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil" ndërsa Neni 46 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka paraparë se cilat konsiderohen shkeljet e lehta: "4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar", në rastin konkret mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankueses në masën e shqiptuar ndaj ankueses nuk ka arritur të konstatoj saktë se cilat nga këto shkelje ka bërë ankuesja përveç në mënyrë të përgjithshme ju ka referuar nenit 46, duke e përshkruar të njëjtin dhe pa konkretizuar secilën shkelje sipas këtyre dispozitave të këtij neni, e që kjo është në kundërshtim me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përgjegjësia disiplinore është përcaktuar si në vijim: *Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"* Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji ka marrë për bazë se arsyetimi i një akti administrativ me shkrim, do të duhej të ishte i bazuar në dispozitat e nenit 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: "1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ.

*Arsyetimi përmban:.....2.shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi”, që në rastin konkret Udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore „vërejtje” përmes formës elektronike të datës 29.07.2021,nuk ka marrë për bazë këto dispozita, dhe se pretendimi ankimor i ankuesit në këtë çështje juridike është i bazuar, nga se në rastin konkret në bazë të provave të lëndës këto dispozita nuk janë marrë parasysh me rastin e shqiptimit të kësaj vërejtje.*

Po ashtu në bazë të provave të lëndës, mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankueses me rastin e shqiptimit të masës disiplinore, nuk ka arritur të konstatoj saktë gjendjen faktike sepse nuk ka arritur të konkretizoj saktë cilën shkelje e ka bërë ankuesja ashtu siç e parasheh ligji, duke mos vërtetuar faktin se nëse ndaj nëpunëses civile më herët është shqiptuar ndonjë masë disiplinore apo se aktualisht mund të ketë ndonjë masë disiplinore që mund të jetë në fuqi ende, rrjedhimisht sipas Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunëses civile me rastin e shqiptimit të masës disiplinore duhet të ketë parasysh dispozitat e nenit 50 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë në të cilën dispozita parashihen,“1.1 shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj,1.2 Shkallën e fajësisë,1.3 Ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të Ligjit,1.4 Përpyjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit”, si dhe nenin 13 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, andaj mbi këtë bazë nga shkresat e lëndës nuk kemi hasur në ndonjë veprim të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë që të aplikojë këto dispozita para se të shqiptojë këtë masë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankueses është masë e rëndë në raport me shkeljen të cilën i ka shqiptuar mbikëqyrësi, në këtë rast mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankueses me rastin e shqiptimit të masës disiplinore rrjedhimisht ka vepruar në kundërshtim me nenin 50 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili parasheh;“2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer “ dhe nenin 13 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë. Po ashtu mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankueses me rastin e shqiptimit të masës disiplinore, të njëjtën nuk e ka arsyetuar në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, gjegjësisht nenin 48 paragrafi 1 dhe të 2 ,nenin 47 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative dhe me nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative në të cilin përcaktohet se: “1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ”, pasi që nuk përmban të gjitha elementet e aktit administrativ, konkretisht nuk përmban pjesën përmbyllëse apo udhëzimin lidhur me këshillën juridike për palën dhe si i tillë edhe është i paligjshëm dhe në kundërshtim me legjislacionin në fuqi që specifikon procedurën e shqiptimit të masave disiplinore.

Organi i punësimit në këtë rast Ministria e Punëve të Brendshme respektivisht Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore është i obliguar që pas këtij vendimi të Këshillit, të ndër marrë veprimet që nga dosja e ankueses të largohet “Vërejtja” e datës 29.07.2021, përmes formës elektronike e shqiptuar nga Drejtori i Drejtoratit për Pajisje me Dokumente, duke vepruar

në pajtim me Ligjin Nr. 06/l - 114 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregulloren (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
Lënda, A.nr.747/2021, datë 20/04/2022

Çlirim Zeka



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankueses
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

